

---

Funded  
by the European Union  
and the Council of Europe



EUROPEAN UNION

COUNCIL OF EUROPE



CONSEIL DE L'EUROPE

---

Implemented  
by the Council of Europe

# Konferenca

“Arsimimi i të kthyerve dhe komuniteteve rome, ashkali dhe egjiptiane: Sfida dhe zgjidhje”

## Raport i përgjithshëm

Nga Klemen Miklavič

Prishtinë, 2 - 3 prill 2014

# Raport i përgjithshëm

Nga Klemen Miklavič

## Sfondi i konferencës

Konferenca “Arsimimi i të kthyerve dhe komuniteteve rome, ashkali dhe egjiptiane: Sfida dhe zgjidhje” ishte pjesë përbërëse e një projekti më të madh dhe përfaqësoi një gur themeli mjaft të rëndësishëm përgjatë zbatimit të projektit. Objektivi kryesor i projektit është të sigurojë një kohezion më të madh social dhe besim mes komuniteteve, si edhe të nxisë zhvillimin socio-ekonomik të të kthyerve të paprivilegjuar dhe komuniteteve rome, ashkali dhe egjiptiane në Kosovë\*. Projekti ka për synim të mbështesë masat aktive të ndërmarra për integrimin dhe përfshirjen e këtyre komuniteteve në sistemin arsimor, veçanërisht shkollimin e tyre. Projekti mbështetet nga ekspertiza profesionale, financimi dhe instrumentet e politikave të Këshillit të Evropës në bashkëpunim me Bashkimin Evropian. Përpjekjet po synojnë një prej përparësive më të larta politike në procesin e vazhdueshëm të rindërtimit social-ekonomik dhe ndërtimit të institucioneve në Kosovën e paskonfliktit.

Projekti aktual mbështet dhe trajton nevojat arsimore të tri kategorive të përfituesve të drejtpërdrejtë:

- 1) Komunitetet rome, ashkali dhe egjiptiane
- 2) Të kthyerit e detyruar nga komunitetet rome, ashkali dhe egjiptiane
- 3) Të kthyerit e detyruar nga komunitetet e tjera

Projekti përqendrohet tek arsimimi cilësor, integrimi social dhe zhvillimi personal i përfituesve të lartpërmendur. Ai ka për qëllim të ndërtojë kapacitetet institucionale lokale nëpërmjet përfshirjes së drejtpërdrejtë të autoriteteve kosovare në aktivitetet e tij, që synojnë:

- Qasjen në arsimin formal dhe frekuentimin e rregullt të shkollës nga komunitetet rome, ashkali dhe egjiptiane, si edhe të kthyerit me forcë
- Integrimin e parimeve të arsimit përfshirës dhe ndërkulturor në politikën shkollë
- Integrimin e komuniteteve rome, ashkali dhe egjiptiane dhe të kthyerve të detyruar në komunitetin lokal dhe një rrjet efektiv lokal të mbështetjes sociale
- Për fëmijët rom: njohjen e gjuhës rome në shkolla dhe promovimin e saj si një e drejtë dhe instrument për ndërtimin e një identiteti kulturor pozitiv për fëmijët rom

## Konferenca: programi dhe pjesëmarrja

---

\* Ky emërtim nuk paragjykon qëndrimet mbi statusin dhe është në përputhje me Rezolutën 1244 të KSKB-së dhe Opinionin e Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë mbi Deklaratën e Pavarësisë së Kosovës

Konferenca u zhvillua në datat 2 dhe 3 prill 2014, në Prishtinë. Ditën e parë, në këtë eveniment ishin të pranishëm 220 pjesëmarrës, ndërsa, ditën e dytë, më shumë se 120 pjesëmarrës. Si qeveria qendrore, ashtu edhe pushteti vendor ishin të mirëpërfaqësuar. Një numër prej 25 nëpunësish civilë dhe zyrtarësh politikë kishin ardhur nga qeveria qendrore, kryesisht, përfaqësues të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) dhe Ministrisë së Punëve të Brendshme (MPB). Po kështu, të pranishëm ishin edhe 20 përfaqësues nga Drejtoria e Arsimit dhe Zyrat e Komuniteteve nga komuna të ndryshme. Pjesëmarrja e lartë nga ana e autoriteteve përgjegjëse publike të të gjitha niveleve dhe gjithëpërfshirja siguruan kushtin bazë për një eveniment të suksesshëm.

Edhe shoqëria civile dëshmoi nivel domethënës interesi për këtë temë. Edhe OJQ-të lokale dhe ndërkombëtare me qendër në Kosovë u përfaqësuan në këtë eveniment. Edhe pse jo të gjitha organizatat dhe nismat patën një përfaqësues që të mbante fjalim, ato morën pjesë aktive në diskutimet plenare dhe seancat e punës, duke ngritur, shpesh, shqetësimet e tyre në mënyrë mjaft drejtpërdrejtë dhe duke i pasuruar, për rrjedhojë, diskutimet në mënyrë të konsiderueshme. Me interes të veçantë ishte grupi i ashtuquajtur i *ndërmjetësuesve*, anëtarë të komuniteteve romë, ashkali dhe egjiptiane, të cilët frekuentojnë shkollën apo janë diplomuar rishtazi dhe po ndihmojnë, aktualisht, fëmijët e komuniteteve të tyre për t'u integruar në sistemin shkollor. Diversiteti i auditorit u rrit edhe nga një numër pjesëmarrësish nga institucione të tjera, si ambasada dhe nga bota akademike.

Konferenca pati jehonë edhe në media. Aktiviteti u mbulua nga stacionet televizive dhe një numër gazetarësh të përgjithshëm dhe të specializuar. Mbulimi nga media e zgjeroi shtrirjen e konferencës përtej grupeve të interesit, në publikun e gjerë të Kosovës.

Programi i konferencës përbëhej nga fjalime përshëndetëse prej përfaqësuesve të lartë politikë, ndjekur nga fjalimet kryesore të një sërë ekspertëve të shquar në fushën e pakicave, komunitetit rom, politikave ndërkulturore dhe arsimit. Fjalë u mbajtën edhe nga përfaqësuesit e autoriteteve qendrore e vendore përgjegjëse për komunitetet, të kthyerit, komunitetet dhe politikën e integritit. Pas fjalimeve, u hap seanca plenare e diskutimeve për të gjithë pjesëmarrësit. Gjatë ditës së dytë, diskutimet u organizuan në tri seanca paralele, duke u përqendruar secila mbi një temë të caktuar. Në fund të çdo seance, u përgatitën tri raporte të veçanta, që u paraqitën dhe diskutuan në seancën plenare në vijim. Një tjetër seancë iu kushtua shfaqjes së një filmi dokumentar mbi jetën e dy të kthyerve rom në Kosovë. Filmi u prezantua nga vetë autori i tij, **Z. Sami Mustafa**. Mbyllja zyrtare e konferencës u bë nga Raportuesi i Përgjithshëm në përfundim të diskutimit plenar. Të dyja ditët u pasuruan me program artistik, me një natyrë të fortë folklorike lokale.

### Komentet hyrëse dhe fjalimet përshëndetëse

Konferenca u nderua nga pjesëmarrja e përfaqësuesve të lartë të qeverisë dhe bashkësisë ndërkombëtare. Dy ministra, një zëvendësministër dhe dy drejtorë institucionesh ndërkombëtare të përfshira në projekt nderuan hapjen e konferencës me praninë dhe fjalimet e tyre. Ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, **Z. Ramë Buja**, theksoi rëndësinë e vlerave të barazisë dhe diversitetit për politikën e Kosovës dhe rëndësinë e një arsimit përfshirës, sidomos për ato grupe që, në të shkruarën, nuk kanë qenë tërësisht të përfshira. Ministri i Punëve të Brendshme, **Z. Bajram Rexhepi**, theksoi detyrimin e qeverisë për t'u kujdesur për të kthyerit dhe

rëndësinë e bashkërendimit të ministrave në këtë përpjekje. Në të njëjtën kohë, ai përmendi edhe çështjen e motiveve ekonomike për të emigruar dhe shkallën e lartë të papunësisë në Kosovë, që është një sfidë jo vetëm për të kthyerit, por për të gjithë ata që jetojnë në Kosovë. Po kështu, Z. Rexhepi foli për sfidën e integritit, që lidhet me faktin se, zakonisht, pjesëtarët e këtyre tri komuniteteve nuk e flasin gjuhën shqipe. Z. **Husnija Beskovic**, zëvendësministër për Komunitetet dhe të Kthyerit, theksoi nevojën për të ofruar qasje në arsimin bazë, mbi të gjitha “*strehim, arsim, shëndetësi dhe qasje në tregun e punës*”. Z. **Gëzim Kasapolli**, zëvendësministër për Integritet Evropian, foli për punën e ekipit të tij për vlerësimin e nivelit të zbatimit të strategjisë së integritit. Ai vuri theksin edhe mbi një problem specifik, braktisjen e shkollës nga vajzat, për shkak të martesës në moshë të hershme. Shefi i zyrës së BE-së në Kosovë \*, Z. **Samuel Zbogar**, solli në vëmendje fate tragjike të familjeve dhe individëve, disa prej të cilëve janë integruar, por edhe ri-integruar. Gjithashtu, ai parashikoi se “[...] *do të ketë edhe më shumë të kthyer, pasi Kosova po normalizohet në mënyrë progresive*”. Z. **Tim Cartwright**, kreu i zyrës së Këshillit të Evropës në Prishtinë, iu referua kulturave rome, ashkali dhe egjiptiane dhe nevojës për të ndërtuar respekt për këto kultura.

## Arsimi si institucion kryesor i shoqërive evropiane moderne

Elementi kryesor i konferencës ishte, në të vërtetë, pozicioni qendror i arsimit në shoqëritë evropiane dhe roli i tij në përparimin e demokracisë, të të drejtave të njeriut dhe dialogut ndërkulturor. Ky konceptim i arsimit të lartë u sintetizua nga Z. **Sjur Bergan**, kur iu referua citimit nga libri ‘*El sueno chileno*’ (Ëndrra kiliane), i sociologut Eugenio Tironi: “*Përgjigjja e pyetjes, “ç’lloj arsimi na duhet?”, gjendet në përgjigjen e pyetjes, “ç’lloj shoqërie duam?”*” Përveçse përfaqëson një vlerë thelbësore për civilizimin tonë dhe konsiderohet si e drejtë themelore, arsimi është kyç për prosperitetin e shoqërive moderne. Në ligjërimet moderne publike në Evropë, shpesh, dëgjojmë rreth potencialit ekonomik të personave të arsimuar dhe aftësuar. Sidoqoftë, është pikërisht në skenat pas konfliktit ku gama e gjerë e institucioneve funksionale është thelbësore për normalizimin e situatës. Përparimi dhe stabilizimi institucional merr rëndësi të posaçme në ato fusha kur tensionet dhe meritë ende nuk janë tejkalar plotësisht. Kësisoj, arsimi është i ndërthurur me dinamikën shoqërore në të gjithë sferën publike dhe jo vetëm në lidhje me zhvillimin ekonomik. Në dritën e një perspektive kaq të gjerë, Z. Sjur Bergan i kujtoi pjesëmarrësve se arsimi përmban disa qëllime në një shoqëri, duke renditur katër kryesore, që përfshihen në Rekomandimin e Këshillit të Evropës mbi përgjegjësinë publike për arsimin e lartë dhe kërkimin: përgatitje për punësim të qëndrueshëm, përgatitje për jetën si qytetarë aktivë në shoqëri demokratike; zhvillim personal; zhvillim dhe mirëmbajtje përmes mësimdhënies, mësimnxënies dhe kërkimit të një baze të gjerë njohurish të thelluara<sup>1</sup>.

**Znj. Zoga Çeta**, nga Ministria e Integritet Evropian, e vendosi arsimin në qendër të përpjekjes për integritet. Fjalimi i saj iu referua arsimit si vlerë dhe si institucioni më i rëndësishëm për ecjen përpara të shoqërisë. Z. **Alush Istogu**, nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, vijoi me një ligjërim të ngjashëm të orientuar për nga arsimi, duke folur edhe për procedurat administrative pas kthimit

<sup>1</sup> Rekomandimi CM/Rec (2007)6 mbi përgjegjësinë publike për arsimin e lartë dhe kërkimin

dhe rëndësinë e gjuhës gjatë kalimit në arsimin lokal. Arsimi dhe gjuha qenë temat kryesore ku u përqendruan shumica e përfaqësuesve të ministrive të Kosovës.

Diskutimi në seancë plenare u përqendrua mbi arsimin si institucion kyç në shoqërinë kosovare, si edhe mbi të drejtat e njeriut e mbrojtjen e pakicave si përparësi politike dhe përpjekje shoqërore në të gjitha nivelet e qeverisjes dhe jetës publike. Kjo ide që qëndron në themel u artikulua qartë gjatë gjithë konferencës nga folësit dhe diskutimet në seancë plenare.

## Komunitetet e pakicave si çështje pa kufi

Një sërë folësish e paraqitën çështjen e romëve, ashkalive dhe egjiptianëve në Kosovë si element përbërës të përpjekjes së vazhdueshme në mbarë Evropën për të njohur natyrën e (mëparshme) të lëvizshme të romëve dhe komuniteteve të tjera të pakicave, si pjesë e kulturës së tyre. Folësit më kritikë përmendën sfida serioze me të cilat përballen shoqëritë dhe vendet evropiane, kur i drejtohen komunitetit rom:

*Diskriminimi mbizotëron në shumicën e sferave të jetës publike: arsimi, tregu i punës, shërbimi shëndetësor dhe strehimi. Sa i takon arsimin, shkollimi i izoluar dhe, veçanërisht, praktika e turpshme e dërgimit të fëmijëve në shkolla të posaçme për aftësi të kufizuara mbeten ende të përhapura. [...] Dhuna kundër romëve është ende e pranishme dhe fjalët e urrejtjes kundër romëve duket se po pësojnë rritje, sidomos në Evropën Perëndimore, ku shoqëritë dhe politika duket se nuk janë të afta të përballen me faktin se romët shfrytëzojnë të drejtën e tyre për të lëvizur (nga fjalimi i Z. Stephan Mueller).*

Kështu, përpjekjet e vazhdueshme të autoriteteve dhe shoqërisë civile kosovare janë vetëm njëra pjesë e mozaikut mes nismave të ngjashme në mbarë Evropën. Trajtimi i çështjes së romëve dhe komuniteteve të tjera të pakicave në Kosovë nuk është më shumë apo më pak i rëndësishëm sesa diku tjetër. Edhe pse shqetësime, çështje dhe sfida të tilla janë shumë të ngjashme me vende të tjera në Evropë, specifikat e shoqërive të paskonfliktit, si ajo në Kosovë, i bëjnë çështjet e të kthyerve kryesisht të krahasueshme me vende të tjera të rajonit të Ballkanit Perëndimor.

Sa i përket rajonit të Ballkanit Perëndimor, mund të thuhet se intensiteti i punës për integrimin e komuniteteve rome, ashkali dhe egjiptiane ishte nga më të mëdhenjtë dhe të suksesshmit. Përpjekja pasqyrohet në shumë arritje, si, për shembull, *qendrat e të nxënimit*, orët shtesë, etj. Z. **Muhamet Arifi** e hapi fjalën e tij me nota pozitive për situatën e romëve, ashkalive dhe egjiptianëve në Kosovë, krahasuar me 8 vjet më parë. Ai theksoi arritjet kryesore dhe e informoi të pranishmit lidhur me projektet në vazhdim në këtë fushë. Ai përmendi rolin e rëndësishëm të shoqërisë civile the vuri theksin mbi nevojën për angazhim të mëtejshëm financiar në projektet që lidhen me të tria komunitetet.

## Trashëgimia dhe pajtimi pas konfliktit

**Z. Stephan Mueller** iu referua tensioneve pas konfliktit midis shumicës dhe tri komuniteteve, si një prej sfidave thelbësore. Aleancat dhe meritë janë ende të

shtresëzuar si të shumica, ashtu edhe të komunitetet romë, ashkali dhe egjiptiane. Tensionet që rrjedhin nga çështjet e ndrydhura dhe/ose të pazgjidhura në të shkuarën e afërt kanë sjellë, për pasojë, ligjërimi negativ publikë, që kanë zgjatur gjatë gjithë periudhës pas konfliktit. Në fjalimin e tij, Z. Mueller theksoi se çdo krim duhej hetuar në mënyrën e duhur. Sidoqoftë, përfshirja e individëve nga këto komunitete në krime lufte nuk mund të konsiderohet si bazë për faj kolektiv.

Në fazën e hershme pas konfliktit, rreziku që të kthyerit të përballeshin me armiqësi, për shkak të zemëratës ende të gjallë të shumicës së popullsisë, ishte i lartë. Për pasojë, një pjesë e madhe e kthimeve u vonuan dhe sollën, si rrjedhim, vështirësi shtesë për individët dhe familjet e kthyerat. Z. Mueller renditi vështirësitë në vijim, që janë shkaktuar nga periudha e zgjatur në emigracion:

- Menjëherë pas konfliktit, kishte në dispozicion më shumë burime financiare për rindërtim për të kthyerit, sesa ka pasur gjatë dy viteve të fundit.
- Në shumë vende, pronat apo vendbanimet ku kishin jetuar përpara dëbimit, ishin zënë dhe kthimi në shtëpi ishte bërë i pamundur ose i vështirë.
- Vitet e fundit janë zbatuar rregulla më rigorozë për të kthyerit rishtazi, si, për shembull, është bërë më e ndërlikuar kërkesa për pronësi mbi pronat e paluajtshme sesa ishte menjëherë pas konfliktit.
- Të tria komunitetet janë të nënpërfaqësuar në nivel qeverisjeje dhe të shërbimit civil.

Përveç kësaj, sipas mendimit të disa pjesëmarrësve, fakti që fëmijët romë, ashkali dhe egjiptianë (kryesisht romë) janë regjistruar në sistemin shkollor paralel serb përfaqëson një element që e pengon procesin e pajtimit dhe e lë komunitetin jashtë shtrirjes së institucioneve të Kosovës, duke rritur mosbesimin reciprok midis shumicës dhe pjesëtarëve të komuniteteve të pakicave.

## Motivet e emigracionit dhe debati i kthimeve të detyruara

Çështja e emigrimit të tri komuniteteve shoqërohet ngushtë me prirjen e përgjithshme të emigracionit nga Kosova, që, nga ana tjetër, ka mjaft lidhje me një perspektivë ekonomike që raportohet si e pafavorshme në vend. Përfaqësuesit e autoriteteve kosovare sollën në vëmendje të pjesëmarrësve arsyet ekonomike si shkakun kryesor të largimit nga Kosova të pjesëtarëve të tri komuniteteve. I njëjti interpretim u shfaq në mënyrë të përsëritur gjatë diskutimeve, si nga folësit ashtu edhe nga pjesëmarrësit.

Kthimi lidhet ngushtë me kushtet ekonomike dhe pozitën socio-ekonomike të individëve të riatdhesuar. Disa pjesëmarrës dhe folës argumentuan se vlerësimi i situatës në Kosovë si e qëndrueshme nuk duhet të konsiderohet i mjaftueshëm për t'i kthyer njerëzit në vend. Perspektiva ekonomike e të kthyerve është thelbësore për riintegrimin e tyre me sukses. Po kështu, periudha fillestare pas kthimit është posaçërisht delikate. Sipas disa folësve dhe diskutuesve, mbështetja e autoriteteve publike duhet të jetë e menjëhershme dhe e çliruar nga burokracia. Vështirësitë e punësimit ishin shpesh një eufemizëm për sfidat ekonomike të romëve, ashkallive dhe egjiptianëve. Ndoshta, mundësitë e arsimit dhe punësimit duhen parë si një sfidë e ndërthurur.

Aq më tepër, migracioni i çdo lloji është një përvojë traumatike sa i përket jetës shoqërore të individit. **Dr. Călin Rus** i kujtoi plenumit se zhvendosja nga një mjedis në një tjetër është përvojë traumatike edhe për fëmijët e familjeve të pasura, që lëvizin për arsye biznesi, jo më për njerëzit që përballen me vështirësi ekonomike, të cilët lëvizin drejt destinacioneve të mjediseve më të vështira. Përvojat e migracionit karakterizohen, zakonisht, nga histori të trishtuara, ankthe dhe kushte sfiduese. Kthimi në kushte më pak të favorshme nxit pashmangshmërisht një prirje për të emigruar sërish. **Z. Stephan Mueller** vërejtë se, shpesh, të kthyerit largohen sërish nga Kosova ose drejt Serbisë (komuniteti rom) ose drejt Evropës Perëndimore, pasi nuk shohin asnjë mundësi për të pasur të njëjtën cilësi jetese në Kosovë. Qeveria dhe shoqëria e Kosovës, nga ana tjetër, nuk duhet të heqë dorë dhe duhet të bëjë maksimumin për t'iu ofruar atyre mundësi të barabarta brenda kufijve të mundësive dhe burimeve në dispozicion.

Sipas Dr. Rusi, riatdhesimet e detyruara janë një proces tejet delikat dhe i dyshimtë. Ai deklaroi se: *“Njerëzit duhen inkurajuar fort për t’u kthyer dhe kushtet në Kosovë duhet ta bëjnë këtë të mundur, por riatdhesimi i detyruar nuk ka gjasa të ketë sukses”*. Ky këndvështrim bazohet mbi dilema në rritje të vendeve që presin bashkësi të mëdha emigrantësh. Këto masa dhe veprime nga autoritetet e vendeve pritëse janë shpesh politikisht të pashmangshme, por komenti ngre një argument që kërkon më shumë kujdes kur zbatohet riatdhesimi i detyruar. Kështu, është e nevojshme që vendet riatdhesuese të kuptojnë më mirë efektet e riatdhesimit mbi grupet e prekura sociale.

## Integrimi social, mjetet ekonomike dhe papunësia

Edhe pse diskutimet gjatë konferencës u përqendruan kryesisht mbi arsimin si institucion thelbësor i formësimit të shoqërisë, disa folës dhe shumë pjesëmarrës ngritën vazhdimisht çështjen e gjendjes ekonomike të romëve, ashkalive dhe egjiptianëve, në përgjithësi, dhe të gjithë të rikthyerve pas kthimit. Sipas shumë diskutuesve, teoria lidhur me integrimin e romëve, ashkalive dhe egjiptianëve dhe e të kthyerve në jetën sociale dhe ekonomike në vend është ndryshe prej realitetit të përditshëm. Edhe kur njerëzit përpiqen shumë të gjejnë një punë dhe t’ia dalin me forcat e tyre, ata përballen me mungesë të mundësive dhe mbështetjeje, që, nga ana tjetër, e bën integrimin e tyre të pamundur. Përveç kësaj, pjesëtarë nga komunitetet rome, ashkali dhe egjiptiane theksuan se nuk janë të përfaqësuar në raport të drejtë as në shërbimin civil.

Diskutimi mbi mundësitë ekonomike nxori në pah një lloj tensioni. Pretendimi për mungesën e mundësive të punësimit për këto tri komunitete dhe të kthyerit ngjalli reagime. Një pjesë e pjesëmarrësve shpjegoi se këto grupe sociale nuk janë të vetmet që vuajnë nga papunësia. E gjithë shoqëria kosovare, thanë ata, përballlet me të tilla vështirësi, si mungesa e punës apo rimëkëmbja e dobët ekonomike. Sipas tyre, shpesh, kërkesa për mundësi ekonomike nga ana e komuniteteve të pakicës shpërfill padrejtësisht situatën e përgjithshme në vend, ku të gjitha grupet shoqërore ndihen të pafuqishme në lidhje me mundësitë e punësimit dhe begatinë ekonomike.

## Kulturata rome, ashkali dhe egjiptiane

Ekspertët mbi romët theksuan rëndësinë e kulturës rome, ashkali dhe egjiptiane. Prof. Ljatif Demiri tha se perceptimet e zakonshme të publikut në shumë vende të Evropës e paraqesin komunitetin rom si sfidë, një problem të lënë gjatë pas dore, një çështje sociale dhe, ndonjëherë, si persona me “nevoja të posaçme”. Sipas Prof. Demirit, në vend të kësaj, duhet që të tria komunitetet të njihen dhe kuptohen si bashkësi me një kulturë të gjallë e që merr frymë. Ai theksoi se, “Gjuha dhe kultura rome, ashkali dhe egjiptiane është e gjallë si çdo gjuhë e kulturë tjetër në Evropë. Ato i përkasin trashëgimisë kulturore evropiane e, për rrjedhojë, edhe trashëgimisë kulturore të Kosovës”. Vënia në pah e kulturave rome, ashkali dhe egjiptiane shihet si një mjet për kapërcimin e stereotipeve dhe marginalizimit që vjen si pasojë. Aktualisht, paraqitja e tyre i mistifikon shpesh këto komunitete, duke i fuqizuar stereotipet dhe paragjykimet kundrejt pjesëtarëve të tyre, në vend që t’i ulë ato.

Prof. Demir ishte, gjithashtu, në përkrahje të idesë së shtrirjes së mëtejshme të gjuhës rome si gjuhë e standardizuar në shkollat e rajonit. Ai mendon se gjuha nuk ka ndryshime të konsiderueshme në Ballkan. Sipas Prof. Demir, është thelbësore të ndiqet një politikë e njëtrajtshme për futjen e gjuhës dhe kulturës në programet mësimore. Përveç kësaj, ekziston nevoja për një zhvillim afatgjatë të orientuar të kapaciteteve profesionale në komunitete, për zbatimin e politikës së propozuar.

Trajtimi i gjuhës është thelbësor edhe në ecjen përpara me integrimin. Z. Alush Istogu nga Ministria e Arsimit e konsideroi sfidën e gjuhës si pengesë funksionale për praktikat efektive të integrit. Sipas tij, fëmijët rom, ashkali dhe egjiptian regjistrohen në shkollë pa asnjë njohuri paraprake të gjuhës së shumicës, çka i vendos ata në pozitë të pafavorshme.

Në prezantimin e tij, Dr. Adrian Marsh u përqendrua në nivelin konceptual. Ai foli lidhur me shumësinë e identiteteve dhe historikun e origjinës. Si Dr. Marsh dhe Prof. Demir theksuan nevojën e ndryshimit të promovimit të kulturave rome, ashkali dhe egjiptiane në programin arsimor, duke i bërë ata pjesë përbërëse të programit të përgjithshëm shkollor, të detyrueshëm për të gjitha komunitetet, përfshi shumicën. Prof. Demir bëri thirrje: “mos u trembni nga gjuha rome në shkollën fillore, mos i ngarkoni fëmijët me gjuhën shqipe. Atë do ta mësojnë gradualisht gjatë ecurisë së tyre në shkollë”. Për të mbështetur argumentin e tij, një tjetër pjesëmarrës shtoi se: “Arsimi nuk ka për qëllim t’i indoktrinojë fëmijët, por t’i nxisë ata”.

Kjo deklaratë është veçanërisht me peshë për rastin e shoqërisë kosovare, ku larmia e strukturës dhe identiteteve etnike është mjaft heterogjene. Dr. Marsh e konsideroi pranimin e identiteteve të ndryshme dhe dallimeve gjuhësore si shumë të rëndësishëm edhe në organizimet formale, si sistemi shkollor dhe programi mësimor. Fjalimi i tij tërhoqi vëmendjen te dallimet midis tri grupeve kryesore të diskutuara në konferencë:

[...] “tri komunitetet kryesore do të zgjidhnin aspekte të ndryshme të historisë, traditës, besimit, strukturave martesore, ritualeve për lindjet, vdekjet dhe vajtimin, për të theksuar dallimin nga njëri tjetri. Këta “shenjues kufijsh” janë të rëndësishëm dhe duhen respektuar, në mënyrë që të njihen të drejtat e grupeve dhe individëve për vetpërcaktim, për të vendosur vetë lidhur me çështjet themelore të përkatësisë.”

Në një shënim dërguar organizatorëve pas mbylljes së konferencës, Dr. Marsh theksoi edhe njëherë nevojën për përdorimin e gjuhës së pakicës në shkollë si



dalluese nga gjuha e shumicës, duke e bazuar këtë në projektet e tij kërkimore dhe përvojën si studiues. Prej këtej, ai përafroi mendimin e tij me Prof. Demirin, i cili kërkoi një gjuhë të standardizuar romë në Gadishullin e Ballkanit. Dr. Marsh rekomandoi:

*“Njohja e ‘gjuhës amtare’ të fëmijëve, si mjet i futjes së standardeve të fundit zyrtare të kësaj dhe gjuhës së shumicës (shqip dhe serbisht) iu ofron mësuesve dhe komuniteteve gjatë viteve të para mundësi të përgatiten më mirë për arsimin fillor dhe për të ndërtuar aftësitë thelbësore për të nxënëit në të ardhme”.*

## Integrimi nuk është asimilim

Gatishmëria për të integruar popullsinë e pakicës në shkollimin e rregullt dhe mekanizmat e tjera institucionale ngre çështjen e rrezikut të rënies nga integrimi në asimilim. Asimilimi është parë për një kohë të gjatë si kërcënim për mbijetesën e formacioneve të vogla kulturore dhe gjuhëve minoritare dhe ka qenë pjesë e dilemës në futjen e masave për integrimin e komunitetit rom në të gjithë Evropën. Me fjalë të tjera, pyetja kryesore në këtë kontekst do të ishte si të sigurohej begatia e komuniteteve romë, ashkali dhe egjiptiane, pa u asimiluar nga shumica. Kjo e fundit do të vinte në rrezik gjuhën dhe kulturën e tyre në përgjithësi.

Sidoqoftë, kur bëhet fjalë për arsimin, çështja merr ndjeshmëri të veçantë. Arsimi konsiderohet gjerësisht si institucioni që priret të riprodhojë kulturën dominuese dhe, si e tillë, kërcënon veçoritë e grupeve më të dobëta e marginale. Dy ekspertë të gjuhës romë sugjeruan që komunitetet romë, ashkali dhe egjiptiane të konceptualizoheshin si njësi kulturore në shkallë të plotë, përfshi ndryshimin e programeve mësimore të shkollave të përgjithshme. Siç përmendet më lart, zgjidhja e tyre do të ishte futja e kulturës romë, ashkali dhe egjiptiane në programin mësimor shkollor, si pjesë e trashëgimisë kulturore. Sipas diskutimeve të mëparshme, në vendet e Evropës Juglindore, gjuha romë e standardizuar mund të futet si gjuhë mësimore gjatë arsimit parashkollor dhe fillor. *“Sfida kryesore për të ardhmen është promovimi i gjuhës romë dhe kulturës romë në shkollat e përgjithshme”*, u shprehën ekspertët, që mbështetnin integrimin e gjuhës dhe kulturës romë në programin mësimor.

Procesi i kundërt me asimilimin, që i trembte po njësoj anëtarët e panelit, folësit dhe pjesëmarrësit, ishte “getoizimi”. Diskutimet nxorën në pah një mendim të qartë dhe të artikuluar se veçimi i romëve, ashkalive dhe egjiptianëve nuk është zgjedhja e duhur. Segregimi dhe trajtimi i komuniteteve të pakicave si “njerëz me nevoja të posaçme” vetëm sa e thellon ndasinë midis pakicës dhe shumicës. Shpesh, pjesëtarët e tri komuniteteve konsiderohen si të lidhur me problemet sociale, sjelljen kriminale dhe praktika të tjera, që hasen më së shumti në grupet më pak të pasura sociale. Kjo, sipas Dr. Demir, mund të projektohet në ligjërimet dhe perceptimet publike. Sidoqoftë, përfaqësuesit e autoriteteve lokale kosovare ishin veçanërisht të shprehur për refuzimin e politikës së trajtimit të komuniteteve të pakicave si grupe me nevoja të posaçme.

## Përplasja e vlerave e të kthyerve

**Z. Stephan Mueller** solli në vëmendjen e pjesëmarrësve të konferencës përplasjen e vlerave tek emigrantët e kthyer, sidomos të rinjtë, të cilët mund të kenë emigruar në fëmijërinë e hershme ose në rini. Ai vuri në dukje sfidat me të cilat këta të rinj mund të përballen:

*“Të kthyerit nga Evropa Perëndimore kthehen, shpesh, me një sistem vlerash, qëndrimesh dhe mendësish kulturore që janë të ndryshme nga ato që mbizotërojnë në vendin e kthimit. Të rinjtë, sidomos vajzat e rritura në Evropën Perëndimore, përballen në mënyrë të papritur me një kulturë e stil jetese të karakterizuar nga pritshmëri me të cilat nuk janë mësuar dhe nuk mund t'i përmbushin. Ato kanë të tjera pritshmëri prej autoriteteve dhe shoqërisë dhe pritshmëri të ndryshme mbi mënyrën si funksionon jeta publike”.*

Filmi dokumentar që u shfaq ditën e dytë të konferencës trajtonte vështirësitë e kthimit. Autori kishte ndjekur dy të kthyer të detyruar dhe përshkruante përvojën e tyre. Ai theksoi vështirësitë e konstatuara që hasnin këta njerëz pas kthimit. Diskutimi nxirrte në pah nevojën për rritjen e ndërgjegjësimit të autoriteteve të vendeve evropiane, që i dërgojnë këta njerëz mbrapsht në vendin e origjinës, pavarësisht nga rreziqet dhe vështirësitë e mundshme me të cilat do të hasen pas kthimit. Kështu, shqyrtimi i rasteve të kthimit në nivel individual mund të ishte një zgjidhje e këshillueshme e problemit të përplasjes së vlerave të të kthyerve.

### **Prindër, mësues, qendrat e të nxënit (learning centres) dhe autoritetet lokale**

Ndërlidhja midis shkollës dhe shtëpisë u trajtua në disa raste nga këndvështrime të ndryshme. Diskutuesit treguan për përpjekjet e shumta përkushtuar ngushtimit të hendekut midis këtyre dy botëve. Bashkëpunimi dhe bashkërendimi midis akterëve u theksua si kusht bazë për veprime të mëtejshme, sidomos në një prej seancave paralele të zhvilluara për këtë temë. *Ndërmjetësuesit dhe qendrat e të nxënit* (projekte të dedikuara për të ndihmuar fëmijët rom, ashkali dhe egjiptianë) u njohën si kontribute pozitive për të forcuar urat midis shkollave dhe tri komuniteteve.

Sipas **Dr. Calin Rus**, është tejet e rëndësishme që t'iu drejtohem *mësuesve* dhe drejtorëve të shkollave, të cilët kanë rol kryesor në procesin e integritimit. Çështja kryesore lidhur me aktorët e sistemit është si t'i motivojmë dhe mbështesim ata për të ndërmarrë veprime. Dr. Rus sugjeroi se duhet hartuar një politikë arsimore e qartë, koherente dhe transparente, e mbështetur nga autoritetet lokale dhe Ministria e Arsimit. Mësuesit duhet të trajnohen në ekipe, me qëllim që të ndërgjegjësohen si duhet në lidhje me ndikimin që mund të kenë. Po kështu, duhen ofruar burime pedagogjike dhe duhen futur në zbatim qasje novatore, për të lehtësuar e përmirësuar punën e tyre. Këto trajnime duhet të konsiderohen si mundësi për reflektim, shkëmbim dhe lidhje në rrjet.

**Qendrat e të nxënit** u përmendën disa herë gjatë diskutimit. Duket se ato pranoheshin si ide e mirë. Megjithatë, duhet të zhvillohen më tej. Disa pjesëmarrës e vunë në dyshim qëndrueshmërinë e qendrave të të nxënit dhe vazhdimësinë e punës së tyre. Gjithashtu, u rekomandua që qendrat e të nxënit të vendoseshin brenda mjediseve të vetë shkollave, në vend që të lireshin diku tjetër në qytet. Gjatë seancave të punës, pjesëmarrësit pranuan nevojën për rritjen e kapacitetit të qendrave dhe inkurajuan ndërmjetësimin e tyre midis shkollës dhe shtëpisë, duke monitoruar frekuentimin e nxënësve dhe luftuar shkallën e braktisjes.

**Ndërmjetësuesit** vërtetuan se ishin aktivistë të angazhuar, të cilët kishin njohuri unike si për botën e shkollës, ashtu edhe për atë të shtëpisë të tri komuniteteve. Duke qenë vetë anëtarë të komuniteteve romë, ashkali ose egjiptiane, ata e kishin të lehtë t'u qaseshin dhe të gëzonin besimin e familjeve dhe fëmijëve. Nga ana tjetër, ndërmjetësuesit frekuentojnë një nivel më të lartë arsimor ose janë të sapodiplomuar. Përveçse kanë potencial të jashtëzakonshëm për të vepruar në nivelin mikro dhe për të përmirësuar gjërat atje, ata, gjithashtu, kanë njohuritë më të sakta mbi problemet dhe sfidat e përditshme të tri komuniteteve. Për rrjedhojë, ata mund të angazhohen si kanale reagimi, që ofrojnë kontribut për politikën, programet dhe aktivitetet e tjera në mbështetje të integritit. Kuptohet që duhet një nivel i lartë i të kuptuarit të realitetit të njerëzve të këtyre komuniteteve, i problemeve të tyre, frikërave, praktikave, bindjeve, shqetësimeve, normave, vlerave, traditave, etj., që të hartohen politika të plota dhe efektive. **Z. Muhamet Arifi** përmendi në fjalën e tij se një numër i konsiderueshëm i moderatorëve dhe përfaqësuesve vinin nga OJQ-ja "*Balkan Sunflowers Kosova*," nismëtari i së cilës mori pjesë në konferencë. Ndërmjetësuesit ishin veçanërisht aktivë gjatë diskutimeve në seancë plenare.

## Integrimi i grave dhe vajzave

Në disa raste, diskutuesit ngritën çështje që lidheshin me vajzat e paprivileguara romë, ashkali dhe egjiptiane. Ata u shprehën se, ndonjëherë, familjet hezitojnë t'i dërgojnë vajzat në shkollë, sidomos në nivelet më të larta të arsimit. Problemet gjinore u identifikuan edhe për çështje të tjera, që jo domosdoshmërisht lidhen me arsimin. Në mënyrë që të trajtohen sfidat me të cilat përballen gratë e reja nga komunitetet romë, ashkali dhe egjiptiane, u rekomandua t'u ofrohej mbështetje shtesë që të ndërtonin besimin në vete dhe këmbënguljen, që, nga ana tjetër, lehtëson regjistrimin e tyre në shkollë dhe vazhdimin e studimeve. Sugjerimet nga seanca e punës nr. 3 ("roli i kulturës dhe gjuhës për të përfshirë të kthyerit në Kosovë në sistemin arsimor"), ku u trajtuan këto ide, ishin përmirësimet që mund të arriheshin nëpërmjet veprimtarive jashtëshkollore, duke shfrytëzuar përvojën e grace nga komunitetet romë, ashkali dhe egjiptiane dhe rrjetet e tyre. Këto aktivitete duhet të zhvillohen më tej aty ku ekzistojnë dhe fillojnë aty ku mungojnë.

## Të sapoardhurit (të kthyerit) si protagonistë

Këndvështrimi mbi kulturën e komuniteteve të pakicës në raport me programin mësimor dhe përvojën arsimore për të gjithë nxënësit dhe studentët lidhet gjithashtu me idenë e fëmijëve imigrantë (të kthyer) si protagonistë të procesit arsimor. Rasti studimor gjerman që u mirëprit ilustronte zhvendosjen e paradigmës drejt qasjeve të integritit të fëmijëve imigrantë. **Dr. Ulrike Wolff-Jontofsohn** prezantoi përvojën e integritit të fëmijëve imigrantë në Berlin. Në shkollat e brendshme urbane në Berlin, ku shumica e fëmijëve që kanë përvojë migracioni, përfshi një përqindje të lartë të fëmijëve rom nga Evropa Juglindore, janë bërë përpjekje për të marrë në konsideratë nevojat e fëmijëve refugjatë rom në shkollat gjermane. Projekti "*Orët e mirëseardhjes*" për fëmijët imigrantë të sapoardhur pa asnjë njohuri nga gjuha gjermane është zbatuar në shkollë. Aktivitetet e projektit marrin parasysh nevojën për zhvillim në klasë, të nxënësve social, si edhe konsiderojnë nevojën për ngushtimin e

hendekut midis prindërve dhe shkollës. Bashkëpunimi i tyre i ngushtë dhe i vazhdueshëm me ndërmjetësuesit rom dhe anëtarët e komunitetit rom duket se kanë përmirësuar frekuentimin dhe rezultatet në shkollë. Analizat e para të projektit konstatuan se mësuesit dhe drejtuesit e shkollës janë të prirur të kuptojnë më shumë sfidat e arsimimit të romëve dhe të bëjnë përpjekje për të kapërcyer pengesat organizative dhe psikologjike që mund të pengojnë procesin e integritit të këtyre fëmijëve nga pakicat. Projekti nxiti vëmendje dhe interesimin e pjesëmarrësve, sidomos të nëpunësve civilë.

## Përvoja nga fqinjët

Rastet e praktikave të mira nga Evropa Perëndimore mund të jenë një pikëfillësë e mirë për diskutime dhe për të kërkuar zgjidhje krijuese. Sidoqoftë, është me rëndësi të mbahen parasysh mjedisi lokal konteksti kulturor dhe institucional, si edhe zhvillimet historike. Jo më pak, edhe rajoni i Ballkanit Perëndimor ka pasur përvojë intensive në trajtimin e komuniteteve të pakicave, sidomos gjatë dekadës së fundit, me financimet intensive dhe monitorimin e bashkësisë ndërkombëtare. Për rrjedhojë, duhet parë për praktika që mund të frymëzojnë a shërbejnë si model edhe brenda rajonit.

**Z. Dashmir Osmani** nga komuna e Gostivarit paraqiti disa kontribute të vlefshme në raport me integrimin e komuniteteve romë, ashkali dhe egjiptiane. *Qendra e Informimit të Romëve (RIC)*, në bashkëpunim me *Drejtorinë e Arsimit dhe Kulturës* në komunën e Gostivarit ka organizuar një sërë veprimtarish për të rritur ndërgjegjësimin e frekuentimit të fëmijëve rom në shkollë. Qendra është një aktor kryesor në mbështetjen e prindërve dhe fëmijëve rom për të përfutur arsimin fillor dhe të mesëm. Falë bashkëpunimit të suksesshëm midis prindërve dhe drejtorëve të shkollave, janë ndërmarrë veprimtaritë në vijim:

- Një numër i madh ndërhyrjesh për arsimimin e romëve, projektesh dhe politikash të konceptuara për të rritur aksesin e fëmijëve romë në arsimimin cilësor janë pilotuar dhe zbatuar.
- Ka përpjekje për ta përgatitur më mirë regjistrimin e fëmijëve në arsimin fillor. Në këtë nivel, shërbimet e arsimit parashkollor janë të përqendruara në përmirësimin e aftësive gjuhësore, njohurive bazë në matematikë, aftësive sociale, motivacionit për të nxënë dhe higjienës personale.
- Komuna e Gostivarit ka përcaktuar zëra specifike në buxhet për ndërhyrje në nivel lokal, me synim nxitjen dhe rritjen e frekuentimit të shkollës nga fëmijët rom, përfshi mbulimin e tarifave në kopsht, pajisjen e fëmijëve me libra e fletore, si edhe me pajisjet e nevojshme dhe mbështetjen për nevoja të tjera të nxënësve rom.
- Është vendosur bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit për të mbështetur me bursa studentët rom.
- Janë zhvilluar seminare që synojnë rritjen dhe nxitjen e përfshirjes së prindërve në aktivitetet shkollore.
- Janë organizuar takime, trajnime dhe seminare që kanë për synim rritjen e kapaciteteve të Këshillit të Prindërve Rom.

## Përfundimet kryesore

Ekspertët dhe folësit kryesorë bënë thirrje për veprim në tri nivele kryesore: vendore, qeveritare dhe ndërkombëtare. Vetëm nëse trajtohet në mënyrë të njëkohshme në tri nivele, do të mund të zgjidhen me sukses sfidat arsimore të komuniteteve rome, ashkali dhe egjiptiane, përfshi të kthyerit përkatës. Në nivelin lokal dhe të qeverisjes, vetë komunitetet, shoqëria civile dhe autoritetet duhet të vazhdojnë përpjekjet e tyre për të integruar anëtarët e tri komuniteteve dhe të kthyerit. Në nivel ndërkombëtar, riatdhesimi kërkon më shumë kujdes, përfshi një kuptim më të madh të ndikimit të riatdhesimit mbi të kthyerit në nivel individual dhe grupi. Një sugjerim do të ishte që riatdhesimi të inkurajohet, në vend që të jetë i detyruar.

Me qëllim tejkalimin e stereotipeve, paragjytimeve dhe marginalizimit që vjen si pasojë për komunitetet rome, ashkali dhe egjiptiane, një përfundim që u pranua gjerësisht ishte që kulturat e tyre të bëheshin të dukshme dhe ato të konsideroheshin si një burim. Futja e gjuhës së standardizuar rome në shkollat fillore do e afronte më tepër procesin e arsimimit me fëmijët rom, ndërkohë që do t'ua prezantonte kulturën rome, ashkali dhe egjiptiane nxënësve të komunitetit të shumicës. Rritja e ofertës së gjuhës rome në programin shkollor do të kontribuonte për rritjen e ndërgjegjësimit të komunitetit të shumicës mbi kulturat e pakicës, si pjesë përbërëse e trashëgimisë kulturore kosovare dhe evropiane.

Në nivel mikro, diskutim u zhvillua shpesh rreth “problemeve të jetës reale” të të kthyerve dhe komuniteteve të pakicës. Shpesh, komentet kishin lidhje me pengesat burokratike, kur aplikohet për njohjen e kualifikimeve, dokumentet e pronësisë, ndihmën sociale dhe përfitime të tjera. Pjesëmarrësit sugjeruan se mbështetja e autoriteteve publike duhet të jetë e menjëhershme dhe e çliruar nga burokracitë. Po kështu, dukej se pjesëmarrësit ranë dakord me nevojën për të rritur qasjen në informacion dhe bashkërendimin midis niveleve të ndryshme të qeverisjes dhe organizatave ndërkombëtare që merreshin me këtë çështje.

Vështirësitë në sektorin e punësimit ishin, shpesh, një eufemizëm për vështirësitë ekonomike të anëtarëve të komuniteteve rome, ashkali dhe egjiptiane. Diskutimet treguan nevojën për të trajtuar arsimimin dhe mundësitë e punësimit si një sfidë e ndërthurur. Sidoqoftë, ky problem duhet të shihet në kontekstin e duhur, duke pasur parasysh se e gjithë shoqëria kosovare po përjeton vështirësi ekonomike e shoqërore në rrugën e saj drejt rimëkëmbjes dhe prosperitetit.

Përfaqësuesit e shoqërisë civile të komuniteteve u pranuan si agjentë shumë të rëndësishëm në një sërë përpjekjesh për të mbështetur komunitetet rome, ashkali dhe egjiptiane. Qendrat e të nxënësve dhe nismat e ndërmjetësuesve paraqisnin qasje krijuese për integrimin e tri komuniteteve, sidomos në fushën e arsimit. Shumë thanë se mësuesit mund të ishin njësoj kontribuues të rëndësishëm, të cilët duhen trajnuar dhe përfshirë në të ardhmen. Në mënyrë që politikat e propozuara të gjejnë zbatim, është i nevojshëm zhvillimi strategjik dhe afatgjatë i kapaciteteve profesionale të komuniteteve. Vetë anëtarët e komuniteteve në cilësinë e profesionistëve mund të bëjnë shumë më tepër sesa ndërhyrjet e jashtme.

Sa i përket barazisë gjinore dhe diskriminimit të dyfishtë me të cilin përballen vajzat e komuniteteve rome, ashkali dhe egjiptiane, diskutimet e pjesëmarrësve theksuan nevojën që projekti të trajtojë hezitimin e familjeve për të lejuar pjesëmarrjen e plotë të vajzave dhe grave në arsim dhe jetën sociale. Shembuj të suksesshëm të aktiviteteve jashtëshkollore që promovojnë pjesëmarrjen e grave dhe vajzave nga komunitetet rome, ashkali dhe egjiptiane mund të përdoren si modele për ndërmarrjen e nismave për këtë çështje.

Në përgjithësi, niveli i lartë i pjesëmarrjes, përfshi larminë e organizatave lokale dhe ndërkombëtare dhe përfaqësuesit nga pushteti vendor dhe qendror, si dhe

grupet sociale, kontribuoi që konferenca të ishte shumë e suksesshme. Veçanërisht, gatishmëria e pjesëmarrësve për t'u angazhuar në diskutime, solli komente të vlefshme për ekipin drejtues të projektit, duke treguar se projekti kishte arritur në një pikë shumë të mirë. Kjo nuk do të kishte qenë e mundur pa mbështetjen e jashtëzakonshme organizative dhe zgjedhjen e folësve nga organizatori. Konferenca reflektoi ndikimin pozitiv dhe rëndësinë e madhe të projektit në vazhdim.

E mërkurë, 2 Prill 2014

08:45-09:15	Regjistrimi i pjesëmarrësve
<b>SEANCA PLENARE</b> <b>Kryeson: Z. Azem Guri, Këshilltar Politik (MASHT)</b>	
09:15-09:30	Video hyrëse
09:30-10:15	<b>Hapja dhe fjalimet e mirëseardhjes:</b> Z. Ramë Buja, Ministër i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) Z. Bajram Rexhepi, Ministër i Punëve të Brendshme (MPB) Z. Gëzim Kasapolli, Zëvendës Ministër i Integritimit Evropian (MIE) Z. Husnija Bešković, Ministër i Komuniteteve dhe Kthimit (MKK) Z. Samuel Žbogar, Kryesuesi i Zyrës së Bashkimit Evropian në Kosovë Z. Tim Cartwright, Shef i Zyrës së Këshillit të Evropës në Prishtinë Z. Sjur Bergan, Drejtor i Departamentit për Arsim, Këshilli i Evropës
10:15-11:00	<b>Paraqitja e situatës: cilat janë sfidat kryesore me të cilat përballen të kthyerit dhe komunitetet rom, ashkali dhe egjiptas në një shoqëri moderne në përgjithësi dhe në arsim, në veçanti?</b> - Prezantimet dhe shkëmbimi i pikëpamjeve nga Z. Calin Rus, Drejtor i Institutit Ndërkulturor në Timisoara dhe Stephan Mueller, Drejtor i Programit në Qendrën Evropiane për të drejtat e Romëve Diskutimi moderohet nga Sjur Bergan, Këshilli i Evropës
11:00-11:15	<b>Pauzë për kafe</b>
11:00-11:15	<b>Deklaratë për shtyp</b>
<b>SEANCA 1</b> <b>Arsimimi i të kthyerve dhe komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptas:</b> <b>Korniza e politikave dhe roli i akterëve të ndryshëm</b> <b>Kryeson: Z. Sjur Bergan, Këshilli i Evropës (KE)</b>	
11:15-11:20	<b>Shfaqje artistike</b>
11:20-11:40	<b>Prezantimi i instrumenteve të politikave të Këshillit të Evropës në fushën e arsimimit të minoriteteve.</b> - Znj. Aurora Ailincăi, Këshilltare për Politikën Arsimore për romët, Këshilli i Evropës
11:40-11:55	<b>Si t'i përgjigjen sfidave lidhur me arsimimin e minoriteteve dhe të të kthyerve autoritetet vendore dhe rajonale.</b> - Z. Dashmir Osmani, përfaqësues i Aleancës Evropiane të Qyteteve dhe Rajoneve për përfshirjen e romëve
11:55-12:10	<b>Strategjia për integrimin e romëve, ashkalinjëve dhe egjiptasve dhe efekti i strategjisë në arsim. Çfarë planesh përtej 2015?</b> - Znj. Zoga Ceta, Këshilltare e Ministres së Integritimit Evropian (MIE)
12:10- 12:25	<b>Roli i autoriteteve vendore në arsimimin e të kthyerve dhe komuniteteve: Situata aktuale në Kosovë.</b> - Z. Alush Istogu, Drejtor për politika (MASHT)

12:25- 12:55	<b>Si mund të ndihmoj shoqëria civile në promovimin e arsimit të të kthyerve dhe grupeve minoritare?</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Z. Valeriu Nicolae, Drejtor Rajonal për avokim në World Vision</li> <li>- Z. Muhamet Arifi, anëtar i platformës së OJQ-ve të cilat punojnë me komunitetet rom, ashkali dhe egjiptas</li> </ul>
12:55-13:20	<b>Diskutim</b>
13:20-14:30	<b>Dreka</b>
<b>SEANCA 2</b> <b>Arsimimi i të kthyerve dhe komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptas:</b> <b>Korniza e politikave dhe roli i akterëve të ndryshëm</b> <b>Kryeson: Znj. Enesa Kadic, Udhëheqëse e Divizionit për Komunitete (MASHT)</b>	
14:30-14:35	<b>Shfaqje artistike</b>
14:35-15:00	<b>Promovimi i kulturës rome, ashkallike dhe egjiptase dhe i gjuhës rome.</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Z. Adrian Marsh, Menaxher i Lartë për programe në Fondacionin e Shoqërisë së Hapur</li> <li>- Z. Ljatif Demir, Profesor në Universitetin e Zagrebit</li> </ul>
15:00-15:30	<b>Metodat e mësimdhënies dhe burimet pedagogjike për arsimin ndërkulturor gjithëpërfshirës.</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Dr. Ulrike Wolff-Jontofsohn, Profesor i Pedagogjisë në Universitetin e Freiburgut</li> <li>- Z. Calin Rus, Instituti Ndërkulturor në Timisoara</li> </ul>
15:30-16:30	<b>Kurset e gjuhës dhe mësimi plotësues – parakusht për një integrim të qëndrueshëm. Vështrimet dhe e ardhmja. Tryezë e rrumbullakët me të ftuar:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Z. Fetah Kasumi, Zyrtarë për Arsimin e ulët të mesëm, MASHT</li> <li>- Znj. Flutra Sinani, Zyrtare e Lartë për Arsim dhe Shëndetësi, MPB</li> <li>- Znj. Afërdita Spahiu, Specialiste për Edukim, UNICEF</li> <li>- Znj. Sara Bagnato, Zyrtare për Politika të Komuniteteve/Kthim, OSBE</li> </ul> Diskutimi moderohet nga Z. Giovanni Mozzarelli, Menaxher i Projektit, KE
16:30-17:00	<b>Diskutim dhe përmbyllja e ditës</b>
17:30 – 18:00	<b>Shfaqje artistike</b>
18:00 – 20:00	<b>Darka</b>

**E enjte, 3 Prill 2014**

<b>SEANCA 3</b> <b>Nga realiteti tek politikat dhe masat: diskutim i grupeve paralele</b> <b>Kryeson: Katia Dolgova-Dreyer, Koordinatorë Projekti (KE)</b>	
09:00-09:10	<b>Hapja e ditës së dytë</b>
09:10-10:40	<b>Seancat paralele</b>
	<b>Seanca paralele 1: "Çfarë kapacitete posedojnë autoritetet qendrore dhe rajonale për tu përgjigjur sfidave?"</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Moderator Z. Calin Rus</li> </ul>
	<b>Seanca paralele 2: "Çfarë shërbime shtesë mund të sigurohen për rritjen e qasjes në arsimim për fëmijët e kthyer (roli i Qendrave Mësimore dhe Ndërmjetësuesve) "</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Moderuar nga Valeriu Nicolae dhe Znj. Juliana Oildashi-Berisha, Zyrtare e Lartë e Projektit, KE</li> </ul>



	<b>Seanca paralele 3: "Roli i kulturës dhe gjuhës për t'i përfshirë më tej të kthyerit në sistemin arsimor të Kosovës"</b> - Moderator Z. Adrian Marsh and Z. Ljatif Demir
10:40-11:00	<b>Pauzë për kafe</b>
11:00-11:30	<b>Raporti nga seancat paralele</b>
11:30-12:00	<b>Projektim i filmit dokumentar</b> nga Z. Sami Mustafa (15 minuta ekstrakt) dhe një panel diskutimi
12:00-12:20	Konkluzionet nga Raportuesi i Përgjithshëm i Konferencës - Z. Klemen Miklavić, Universiteti i Evropës Qendrore, Budapest
12:20-12:30	<b>Përmbyllja e konferencës: Fjala përmbyllëse</b>
12:30- 12:35	<b>Shfaqje artistike</b>
12:35-14:00	<b>Dreka</b>
14:00	<b>Largimi i pjesëmarrësve</b>